**VENDIM**
**Nr.610, datë 24.8.2011**

# PËR MIRATIMIN E SHTESËS NR.1 TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN, PËR PROGRAMIN KOMBËTAR, IPA, 2007, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E PARAZGJERIMIT, KOMPONENTI I - ASISTENCA E TRANZICIONIT DHE MBËSHTETJES INSTITUCIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e shtesës nr.1 të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian, për programin kombëtar IPA, 2007, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, komponenti I — Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale, miratuar me vendimin nr.24, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Parazgjerimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**